

VENDIM
Nr.1636, datë 17.12.2008

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, NË
UNIVERSITERTIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË, SI DHE PËR MIRATIMIN E
KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME
NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, në Fakultetin e Shkencave Teknike, të programeve të studimit të ciklit të dytë, si më poshtë vijon:

- i) “Inxhinieri navale”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma e nivelit të dytë, DND;
- ii) “Matematikë”, në përfundim të të cilit lëshohet diploma e nivelit të dytë, DND.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Kuota e pranimeve në programet e mësipërme të ciklit të dytë në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, për vitin akademik 2008-2009, të jetë, si më poshtë vijon:

- i) Inxhinieri navale 25;
- ii) Matematikë 50.

5. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë shpërndan kuotat e vëna në dispozicion të tij, në masën jo më pak se 30 për qind, për studentët, që kanë përfunduar, të paktën, ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70 për qind, për ata, që i kanë përfunduar këto studime pranë tij. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, atëherë Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, ka të drejtë ta plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, që janë diplomuar në të.

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, të përcaktuara nga njësitë kryesore të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, bëhen publike paraprakisht.

6. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2008, do të jetë sipas pikës 6.b).I, të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimin në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i dytë i studimeve dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009”.

7. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si: të verbrit, të shurdhët, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentët me aftësi të kufizuara, fëmijët romë apo fëmijët e policëve, të rënë ose të plagosur për shkak të detyrës, të të ish-të përndjekurve politikë, që do të fitojnë të drejtën të ndjekin një program studimi, të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, do të paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

9. Në çdo program studimi, të ciklit të dytë, të studimeve me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët e shkëlqyer, nga cikli i parë dhe nga cikli i dytë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

10. Kuotat e pranimeve në programet e studimit të ciklit të dytë, sipas pikës 4, që mbeten të parealizuar, rishpërndahen, sipas programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha